



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMUNA E PRIZRENIT  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 58 shkronja h), të Ligjit me Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 50 shkronja l), të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës,

## PROPOZON

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 2, shkronja c), dhe nenit 17 shkronja r), të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ( "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" , nr 28), të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L – 145, për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, të nenit 17 të Udhëzimit administrativ nr. 9/2010, për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të veprimit rinor në Kosovë dhe të nenit 20 paragrafi 1 pika 20, neni 25 paragrafi 1 shkronja a), të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës bie këtë,

## RREGULLORE PËR

### KËSHILLIN E VEPRIMIT RINOR LOKAL TË PRIZRENIT

#### I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1.

##### Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e themelimit, përfaqësimit, detyrat, përgjegjësitë, funksionimi, burimet financiare dhe mbështetja financiare, procedurat e ankesave, shpërbërja e KVRL - së.

##### Neni 2.

##### Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje termat në vijim kanë këtë kuptim:

„**Udhëzimi administrativ**“ – nënkupton Udhëzimin administrativ nr. 9/2010 për përgjegjësinë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të veprimit rinor të Kosovës.

„**Drejtori**“ - nënkupton organin e administratës së komunës përgjegjëse për rini;

„Zyrtar Rinor“ - nënkupton zyrtarin përgjegjës për rini në Komunë:

„KVRL“ - nënkupton Këshillin e Veprimit Rinor Lokal në Komunë.

“Kuvendi i KVRL – së” - nënkupton Kuvendin përfaqësues të organizatave rinore anëtare të KVRL - së.

“Bordi Ekzekutiv” - nënkupton kryetarin, nënkryetarin, sekretari dhe anëtarët.

## **II. DISPOZITAT E VEÇANTA**

### **Neni 3.**

#### **Themelimi i KVRL - së**

1. Zyrtari rinor fton organizatat dhe grupet tjera rinore të Komunës për krijimin e këshillit inicues për themelimin të KVRL - së.
2. Këshilli inicues përgatit mbajtjen e kuvendit për themelimin e KVRL - së.
3. Kuvendi nga përfaqësuesit e Organizatave anëtare, zgjedh Bordin Ekzekutiv të përbërë prej Kryetarit, nënkryetarit, sekretarit dhe anëtarëve.
4. Kuvendi autorizon Bordin ekzekutiv për hartimin e Statutit dhe Rregullorës së punës të KVRL - së.
5. Pas miratimit të Statutit dhe Rregullorës së punës në Kuvend, Bordi ekzekutiv bën kërkesë për regjistrim sipas ligjit në fuqi, të cilat vlejnjë për organizata joprofitabile.
6. Pas regjistrimit, KVRL bën kërkesë me shkrim në Drejtorinë përkatëse për rini të Komunës për njohje në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Udhëzimit administrativ.

### **Neni 4**

#### **Përfaqësimi**

Përfaqësimi i Organizatave dhe grupeve rinore në KVRL bëhet sipas nenit 11 të udhëzimit administrativ.

### **Neni 5.**

#### **Detyrat:**

Përveç detyrave të parapara në dispozitat e nenit 10 të Udhëzimit administrativ, KVRL ka edhe këto detyra:

- a) Të njoftoj zyrtarin e rinisë për takimet e rregullta.
- b) KVRL mbështet Organizatat anëtare për përgatitje të projekteve dhe aplikim për fonde.
- c) KVRL ka për detyrë të informoj zyrtarin e rinisë për projektet e ndryshme të organizatave anëtare.

### **Neni 6.**

#### **Përgjegjësitë**

Përveç përgjegjësiave të parapara në dispozitat e nenit 10 të udhëzimit administrativ, KVRL ka edhe këto përgjegjësi:

- a) Bashkëpunimi me Këshillat Rinor në nivel lokal dhe këshillin rinor në nivel qendror dhe ndërkombëtar.
- b) Organizimin e seminareve, debateve, punëtorive, fushatave vetëdijësuese për çështje rinore në nivel lokal.

- c) Promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit.

## **Neni 7.**

### **Funksionimi**

1. Funksionimi i KVRL - së bëhet përmes:

- a) Kuvendit të KVRL - së,
- b) Bordit drejtues,

2. Kuvendi i KVRL -së përbëhet nga të gjitha organizatat dhe grupet rinore të cilat janë të paraparë me Statutin e KVRL - së

3. Bordi ekzekutiv ka kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe anëtarët.

4. Kuvendi ka përgjegjësi për mbajtjen e së paku një takimi vjetor ku do të shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet, programet e këshillit për vitin paraprak, si dhe planin për mjetet, të ardhurat, shpenzimet dhe programin e këshillit për vitin vijues.

5. Kuvendi i KVRL nuk i delegon detyrat:

- a) Detyrat sipas paragrafit 4 të këtij neni,
- b) Zgjedhjen e zyrtarëve në pozitë udhëheqëse të KVRL - së,
- c) Ndryshimet dhe plotësimet në aktin themelues apo statutin e KVRL - së dhe,
- d) Vendimet për bashkimin, ndarjen, apo shuarjen e KVRL - së.

## **Neni 8.**

### **Burimet financiare**

Mjetete financiare të KVRL - së janë:

- a) Kontributet nga përfaqësimi i Organizatave në KVRL ,
- b) Subvencionet nga të hyrat vetanake të Komunës,
- c) Subvencionet nga niveli qendror dhe subvencionet nga autoritetet ndërkombëtare.
- d) Donacionet dhe subvencionet nga organizata tjera, individët ose sponsorët e ndryshëm,

## **Neni 9.**

### **Mbështetja teknike dhe financiare**

1. Drejtoria kompetente për punë rinore në kuadër të buxhetit të miratuar të komunës dhe planit të veprimit për rini, mbulon të gjitha shpenzimet që rezultojnë përkitazi me organizmin e mbledhjes së kuvendit të KVRL – së, takimeve të kryesisë, dhe aktiviteteve rinore.

2. Drejtoria kompetente për rini sipas mundësive dhe nevojës do të mbulojë edhe shpenzime tjera për ushtrimin e aktiviteteve të KVRL-së.

3. Drejtoria kompetente për rini, siguron hapësirën dhe pajisjet teknike/teknologjike për funksionimin e punës së KVRL-së.

## **Neni 10.**

### **Konflikti i interesit**

1. KVRL aplikon për programe specifike si:

- a) Ngritja e kapaciteteve të Organizatave anëtare;
- b) Realizim të fushatave informuese dhe vetëdijësuese;
- c) Përmirësimi i nivelit të pjesëmarrjes së rinisë në aktivitete;
- d) Shkëmbimi i përvojave në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar.

2. Anëtarët e KVRL - së do të përmbahen nga pjesëmarrja në diskutim si dhe nga marrja e vendimit apo çështjeve të cekura në pikën 1 të këtij neni në të cilat ata kanë interes personal ose financiar.

3. Secili transakcion financiar ndërmjet KVRL - së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit, për çështjen e cekur në paragrafin 1, domosdo duhet të bëhet në vlerën e tregut ose në kushte më të favorshme për KVRL - në.

## **Neni 11**

### **Procedura e ankesës**

Ndaj vendimit të Kryetarit të Komunës, për refuzimin e njohjes së KVRL - së, mund të ushtrohet ankesë Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve - Departamentit të Rinisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit të procedurës administrative në fuqi.

## **Neni 12**

### **Shpërbërja e KVRL - së**

Shpërbërja e KVRL - së bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatat jo fitimprurëse.

## **Neni 13**

### **Zbatimi**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunes dhe Drejtoria kompetente për rini e Komunës.

## **III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

## **Neni 14**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj në Kuvendin e Komunës së Prizrenit